



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 22 Janar 2022

Nr: 1

UDHËZIM
PËR

DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 23.12.2020, TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE, "PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR DEPOZITIMIN E VERIFIKIMIN E DOKUMENTACIONIT TË KANDIDIMIT, AFATET PËR PUBLIKIMIN E LISTAVE TË KANDIDATËVE DHE MIRATIMIN E MODELEVE TË KANDIDIMIT"

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n", dhe 2, 64, pika 2, shkronja "e", 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, dhe 92/2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015" dhe të nenit 144, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020, Model 03/1 dhe Model 05, zëvendësohen me modelet me të njëjtin numër, që i bashkëlidhen këtij udhëzimi.
2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij udhëzimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 22 Janar 2022

Nr. 1

"Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020, të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit"

DEKLARATË

	e kandidatit të listës shumemërore Partia Politike/ Koalicioni	e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit	e kandidatit për kryetar bashkie
(Përzgjidh me X)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

(plotëso emrin e kandidatit të listës shumemërore /
kandidatit të propozuar nga zgjedhësit, kandidati
për kryetar bashkie)

Zona Zgjedhore Qarku _____ **Bashkia** _____

në zgjedhjet _____, **të datës** ____ . ____ .20____,

Bazuar në nenin 92/2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

Unë _____ kandidat i listës shumemërore i partisë politike / koalicionit _____ deklaroj se kam hapur llogari të posaçme me numër _____, pranë Bankës _____;

Unë _____ kandidat i propozuar nga zgjedhësit deklaroj se kam hapur llogari të posaçme me numër _____, pranë Bankës _____;

Unë _____ kandidat për kryetar bashkie deklaroj se kam hapur llogari të posaçme me numër _____, pranë Bankës _____;

Referuar nenit 92/2, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, autorizoj Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe të ngarkuarit e saj për të marrë drejtpërdrejt nga banka të dhëna për të gjitha transaksionet e llogarisë.

Emër, mbiemër, firma



Kujdes !

Mënyra se si duhet të plotësohet ky dokument

1. Kryetari i partisë politike / kandidati i listës shumemërore i partisë/ koalicionit apo kandidati i propozuar nga zgjedhësit plotëson emrin e subjektit propozues, zonën zgjedhore, ndërsa për zgjedhjet e organeve të vetëqeverisjes vendore plotëson bashkinë ku kandidon.
2. Të dhënat identifikuese të deklaruesit duhet të plotësohen gjithmonë me germa kapitale ose me kompjuter sipas dokumentit të identifikimit.
3. Kandidati përzgjedh opsionin e deklaratës bazuar në subjektin propozues/ kandidatin e propozuar nga zgjedhësit.



Kujdes !

Mënyra se si duhet të plotësohet ky dokument

1. Kandidati plotëson emrin e subjektit propozues, zonën zgjedhore, ndërsa për zgjedhjet e organeve të vetëqeverisjes vendore plotëson bashkinë ku kandidon.
2. Të dhënat identifikuese të deklaruesit duhet të plotësohen gjithmonë me germa kapitale ose me kompjuter sipas dokumentit të identifikimit.
3. Kandidati përzgjedh opsionin e deklaratës bazuar në subjektin propozues.
4. Kësaj deklarate, sipas rastit, i bashkëngjitet kopja e deklaratës së dorëheqjes së kandidatit nga funksionet e përcaktuara në nenin 63, pika 4 të Kodit Zgjedhor, depozituar pranë institucionit përkatës.